



Aplikim për vizë me qëllim lidhje martese ose bashkëjetesë të regjistruar me qëndrim të vazhdueshëm

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhe përmbajuni saktësisht udhëzimeve.

Aplikimet e plotësuar në mënyrë të mangët apo dokumentacioni i paplotë mund të çojnë në refuzimin e aplikimit me pasojë rezervimin e një date të re aplikimi.

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht 8 deri në 12 javë, në raste të veçanta edhe më gjatë. Ndaj lutemi për mirëkuptimin Tuaj për faktin që brenda 8 javëve të para, prej ditës së aplikimit, nuk mund t'u japim përgjigje pyetjeve lidhur me stadin aktual të procedurës.

Për aplikimin ju nevojitet dokumentacioni në formën e përshkruar më poshtë:

1.	Formularë aplikimi për vizë	Në gjermanisht ose anglisht, në dy kopje, të plotësuar në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.	
2.	Tarifa	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhen kesh në monedhën shqiptare LEK . Tarifa është 75 Euro përllogaritur me kursin aktual të këmbimit.	
3.	Fotografi pashaporte	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj, me sfond të bardhë, madhësia 45x35 mm. Lutemi që në secilin prej dy formularëve të aplikimit të ngjisni nga një fotografi, ndërsa fotografinë e tretë silleni me vete si element të veçantë.	
Dokumentat e mëposhtme duhen dorëzuar në origjinal, <u>me 2 fotokopje</u>, në momentin e aplikimit			
4.	Pashaporta e udhëtimit	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.	
5.	Certifikatë lindjeje	Certifikata personale e lindjes së fëmijës e përkthyer dhe e pajisur me vulën apostille.	

6.	Regjistrim i lidhjes martesore pranë një zyre gjermane të gjendjes civile Ose Vërtetim i një zyre gjermane të gjendjes civile për plotësimin e të gjitha kriterëve për një lidhje martesore	<i>Ju lutem mbani në konsideratë që gjithsesi vërtetimi i regjistrimit të lidhjes martesore pranë një zyre gjermane të gjendjes civile duhet të paraqitet maksimumi deri në lëshimin e vizës! E njëjta gje vlen edhe për përcaktimin e datës konkrete të lidhjes martesore!</i>	
7.	Pashaportë / kartë identiteti / leje qëndrimi e të fejuarit/ës në Gjermani	Nëse i fejuari / e fejuara nuk ka nënshtetësinë gjermane, atëherë duhet të paraqitet pashaporta e udhëtimit dhe leja e vlefshme e qëndrimit. (Këtu mjafton të paraqisni 2 kopje)	
8.	Dëshmi për vendbanimin nga Gjermania	Vërtetim për vendbanimin e të fejuarit /ës në Gjermani lëshuar përmes zyrës së regjistrimit (jo më herët se para 6 muajsh)	
9.	Deklaratë me shkrim e të fejuarit / ës që banon në Gjermani sipas §§ 66-68 të Ligjit për të Huajt	I fejuari / e fejuara duhet të deklarojë me shkrim se merr përsipër kostot që mund të lindin deri në momentin e lidhjes martesore në përputhje me §§ 66 – 68 të Ligjit për të Huajt.	
10.	Dëshmi për njohuritë e gjuhës gjermane	Njohuri të thjeshta mbi gjuhën gjermane mund të dëshmojnë parimisht nga një certifikatë gjuhe në nivelin „Deutsch – A1“ (e lëshuar jo më herët se para një viti). Informacione më të hollësishme për këtë mund të gjeni në fletën e informacionit „Dëshmi e njohurive të gjermanishtes në procesin e aplikimit për vizë“.	
11.	Siguracion shëndeti në rast udhëtimi	Për të paktën javët e para të qëndrimit të planifikuar në Gjermani është e nevojshme të lidhet një siguracion shëndeti (ndërsa për periudhën vijuese duhet lidhur një i tillë në Gjermani).	
12.	Eventualisht deklaratë formale garancie ose vërtetim page për tre muajt e fundit ose vërtetim aktual taksash i të fejuarit/ës që jeton në Gjermani	Nëse i fejuari / e fejuara juaj në Gjermani nuk ka shtetësinë gjermane ai/ ajo duhet të bashkangjisë një vërtetim për financa të mjaftueshme për jetesën e tij dhe të partnerit/	
13.	Eventualisht kontratë qeraje e të fejuarit/ës që jeton në Gjermani	Nëse i fejuari / e fejuara juaj në Gjermani nuk ka nënshtetësinë gjermane, atëherë duhet të paraqitet një vërtetim për hapësirë të mjaftueshme banimi për vete dhe bashkëshortin/en apo partnerin/en.	

Në raste të veçanta, gjatë aplikimit apo procedurës së vizës, mund të kërkohen dokumenta të caktuara të papërmendura më sipër

Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.